

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **MTKRS** me objekt: “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë ekonomiko financiare dhe vlerësues, për periudhën 1/10/2010 deri më 31/3/2012*” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.122, datë 06/08/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 402/12, datë 06/08/2012 dërguar **Z. Aldo Bumçi, Ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Nga auditimi i kryer në MTKRS, u konstatua se, në Rregulloren e Brendshme të institucionit, nuk janë përcaktuar detyra konkrete për çdo Drejtori, Sektor dhe deri në punonjës të veçantë, në lidhje me programimin e fondeve për artin, kulturën, librin, rininë dhe sportet, për zbatimin e kritereve të përcaktuara në dispozitat ligjore dhe në kontratat e lidhura midis palëve (rekomandim i lënë edhe në raportin përfundimtar të mëparshëm, për të cilën nuk është marrë asnjë masë për zbatim).

Për këtë, **rekomandojmë:**

- Marrjen e masave për ripunimin e Rregullores së Brendshme të institucionit dhe përcaktimit të detyrave konkrete për çdo Drejtori, Sektor dhe deri në punonjës të veçantë, në lidhje me detyrat dhe funksionet që ushtrojnë konform dispozitave ligjore dhe përshkrimeve të punës, në funksion të misionit për arritjen e objektivave të MTKRS.

**Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Drejtoria e Juridike
Menjëherë**

2. Nga auditimi u konstatua se, në pikën 1, të VKM nr. 315, datë 8/7/1999 “Për një ndryshim në VKM nr. 150, datë 3/4/1993, “Për financimin e projekteve kulturore, artistike të personave fizikë juridike, vendas dhe të huaj”, është përcaktuar se “*MTKRS financon me mjete pune e financiare realizimin e projekteve kulturore dhe artistike, rinore dhe sportive, persona fizike vendas dhe të huaj*”. Ndërsa sipas ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për artin dhe Kulturën” në nenin 23.3, është përcaktuar se, shpenzimet administrative nuk duhet të kalojnë masën 15 % të

vlerës totale të financimit. Në këto kushte, për disiplinimin e shpenzimeve administrative, që në disa projekte shpenzimet për mjete pune janë financuar deri në masën 100%, dhe për të mundësuar shpërblimin e cilësisë artistike dhe vlerave kulturore. Për këtë, **rekomandojmë që:**

-MTKRS të propozojë në Këshillin e Ministrave për ndryshimin e pikës 1, të VKM nr. 315, datë 8/7/1999, në të cilën të përcaktohen në mënyrë analitike dhe të detajuar struktura e shpenzimeve për financimin e mjeteve të punës, në mënyrë që në zbatim të ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për artin dhe Kulturën” pjesa tjetër e shpenzimeve prej 85% të përdoret për cilësinë artistike dhe vlerat kulturore që ndikojnë në realizimin e misionit të institucionit.

**Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Artit
Drejtoria e Librit
Drejtoria e Rinisë
Drejtoria e Juridike
Menjëherë**

3. Në zbatim të ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për artin dhe Kulturën”, të riformulohet udhëzimi i përbashkët ndërmjet MTKRS dhe Ministrisë së Financave nr. 5, datë 18/5/2000, e konkretisht:

a) Pika 4, në “Procedurat e gjykimit dhe të miratimit për financimin e projekteve artistike dhe kulturore”, të përcaktohen rregullat bazë për detajimin e shpenzimeve në preventivin e aplikimit, si dhe kriteret për vlerësimin e shoqërive pjesëmarrëse të cilat të disponojnë asete bazë të nevojshme për realizimin e projekteve artistike dhe kulturore (foni dhe ndriçim) me qëllim uljen e kostos së financimit nga MTKRS;

b) Pika 5, “Zbatimi i procedurave për lëvrimin e fondeve”, në të cilën të përcaktohen rregulla bazë për dokumentimin e shpenzimeve konform dispozitave ligjore për realizimin e projekteve prej fillimit dhe monitorimin e aktivitetit nga përfaqësuesit e MTKRS;

c) Për të gjitha projektet artistike dhe kulturore, që kryhen pagesa për këngëtarë, artistë, regjisorë, drejtues artistikë, etj, apo edhe për pjesëmarrje në juri, MTKRS të marrë masa të menjëhershme për të caktuar kriteret specifike të veçanta për shpërblimin e tyre duke marrë për bazë çmimet e tregut, apo edhe të dhëna nga Instat-i.

**Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Artit
Drejtoria e Librit, Drejtoria e Rinisë
Drejtoria e Juridike
Menjëherë**

B. MASA ORGANIZATIVE

B.1 Për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

1. Nga auditimi i projekteve artistike dhe kulturore rezultoi se, për periudhën objekt kontrolli, respektivisht gjatë viteve 2010 dhe 2011 janë paraqitur dhe miratuar projekte artistike, kulturore dhe janë lidhur kontrata, vlera e të cilave është më e madhe se fondet e çelura nga buxheti i shtetit, e konkretisht: për vitin 2010 në total janë miratuar dhe lidhur kontrata për 74 projekte më tepër për 85,216 mijë lekë, ose 77,7 % më tepër dhe për vitin 2011 miratuar dhe lidhur kontrata për 8 projekte më tepër në vlerën prej 9,190 mijë lekë, ose 12,1 % më tepër. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 50 të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi kanë sjellë vështirësi financiare dhe bllokim të aktiviteteve artistike dhe kulturore për vitet pasardhës.

Për këtë, **rekomandojmë që**, Drejtoritë e Artit dhe të Kulturës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Investimeve, të marrin masa të menjëhershme për respektimin e nenit 50, të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 26 të ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për Artin dhe Kulturën” e konkretisht: **“Të mos lejojnë ndërmarrjen e angazhimeve të reja, përtej kufijve të fondeve buxhetore të miratuara”**.

Drejtoria e Buxhetit dhe Investimeve
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Artit
Drejtoria e Librit
Drejtoria e Rinisë
Drejtoria e Juridike
Në vazhdimësi

2. Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, nuk është krijuar Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës, e cila ka sjellë si pasojë, mosregjistrimin e shoqatave të ndryshme juridike apo fizike kundrejt tarifave të përcaktuara për regjistrimin e tyre si subjekte aplikuese për të përfituar financim nga fondet publike për projektet artistike dhe kulturore, në kundërshtim me nenin 22.b, të ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për artin dhe kulturën”. Gjithashtu në kundërshtim edhe me pikën 2 të VKM nr. 1173, datë 6/11/2009, nuk është çelur regjistri i subjekteve apo shoqatave që kanë eksperiencë në realizimin e projekteve artistike dhe kulturore, i cili do të shërbejë për vlerësimin e shoqërive që plotësojnë kushtet për të përfituar mbështetje financiare për realizimin e misionit të MTKRS dhe seleksionimin e shoqërive dhe individëve të veçantë që nuk mund të jenë sipërmarrës të aktiviteteve artistike dhe kulturore”.

Tashmë QKAK është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 114, datë 15/2/2012.

Për këtë, **rekomandojmë që**, QKAK, të marrë masa për regjistrimin e shoqatave të ndryshme juridike apo edhe fizike, kundrejt tarifave të përcaktuara, për të përfituar

financim nga fondet publike për realizimin e projekteve artistike dhe kulturore, të cilat do të jenë edhe një prej burimeve të buxhetit të QKAK.

Menjëherë

3. Nga auditimi u konstatua se, në kundërshtim me nenin 3, të ligjit nr. 9154, datë 6/11/2003 “Për Arkivat”, procesverbalet e Komisionit të Kulturës dhe dokumente të tjera të hartuara nga Drejtoritë e Artit, të Kulturës, të Rinisë dhe të Sporteve, për vlerësimin e projekteve artistike dhe kulturore, etj, janë pa numër protokolli dhe pa datë, e për rrjedhojë nuk përfaqësojnë dokumente të krijuara dhe të pranuar për t’u arkivuar, sipas përcaktimeve të nenit 18, pika 2 germa a, e ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për artin dhe kulturën.

Për këtë, **rekomandojmë që**, Drejtoritë e Artit, të Kulturës, të Librit, të Rinisë dhe të Sporteve, të marrin masa për hartimin e formularëve tip, si procesverbalet për vlerësimin e projekteve artistike dhe kulturore dhe të dokumentave të tjera që plotësohen sipas radhës kronologjike. Këto dokumente të klasifikohen si materiale që jo vetëm kanë vlera artistike, por mbartin dhe vlera ekonomike, pasi janë formularë dhe dokumenta financiare bazë për likuidimin e shpenzimeve të kryera nga subjektet private të kontraktuar nga përfituesit e projekteve.

**Drejtoria e Artit
Drejtoria e Kulturës
Drejtoria e Librit
Drejtoria e Rinisë
Drejtoria e Sporteve
Drejtoria e Juridike
Menjëherë**

4. Nga auditimi u konstatua se, në kundërshtim me nenin 23.3, të ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për artin dhe kulturën” nuk është detajuar dhe përcaktuar struktura e shpenzimeve administrative të projekteve, të cilat nuk duhet të kalojnë masën 15% të vlerës së gjithë financimit të çdo projekti. Mosdetajimi dhe mospërcaktimi analitik i strukturës së shpenzimeve administrative në masën 15% ndaj totalit të shpenzimeve, dhe diferencës tjetër prej 85%, ka sjellë si pasojë që, të financohen projekte artistike, për akomodim trajtim ushqimor, marrje me qira të pajisjeve për ndriçim dhe foni, madje në disa raste edhe 100% të vlerës së projektit, duke mos i kushtuar vëmendje cilësisë artistike, dhe vlerave promovuese të artit dhe kulturës kombëtare, si një ndër objektivat kryesore të misionit të MTKRS.

Për këtë, **rekomandojmë**, që Drejtoritë Përgjithshme e Politikave të Artit, të Librit dhe të Rinisë të marrin masa për përcaktimin dhe emërtimin e strukturës analitike të shpenzimeve administrative të projekteve artistike dhe kulturore, dhe të

projekteve të librit dhe rinisë, konform nenit 23.3, të ligjit nr. 10352, date 18/11/2010 “Për artin dhe kulturën” për përcaktimin dhe detajimin e shpenzimeve administrative, të cilat të mos kalojnë masën 15% të vlerës totale të financimit të çdo projekti. Ndërsa pjesa tjetër prej 85%, të detajohet kryesisht për cilësinë artistike dhe vlerat kulturore që lidhen me plotësimin e objektivave dhe të misionit të MTKRS në fushën e artit dhe kulturës.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Artit
Drejtoria e Librit
Drejtoria e Rinisë
Drejtoria e Juridike
Menjëherë

5. Nga auditimi u konstatua se, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr 258, datë 12/10/2010 “*Mbi dokumentacionin që duhet të plotësojnë personat fizikë e juridikë vendas, që aplikojnë për mbështetje financiare nga MTKRS dhe procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve*”, në kontratat e lidhur midis palëve, ndonëse janë përcaktuar 2 punonjës të MTKRS, për monitorimin e aktiviteteve të ndryshme artistike, kulturore etj, por asnjë prej tyre nuk është monitoruar. Kjo mangësi ka sjellë si pasojë që, shumë aktivitete nuk janë justifikuar me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 2 të kontratave tip, e për rrjedhojë kanë përfituar në mënyrë të parregullt **vlerën prej 6,913,497 lekë.**

Për këtë, **rekomandojmë**, marrjen e masave dhe parashikimin e shpenzimeve të monitorimit në çdo projekt për dy punonjës respektivisht sipas natyrës së projektit dhe drejtorive respektive, si një ndër masat më të rëndësishme për disiplinimin dhe përdorimin efektiv të fondeve publike nga shoqëritë sipërmarrëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Artit
Drejtoria e Librit
Drejtoria e Rinisë
Drejtoria e Juridike
Menjëherë

6. Nga auditimi i kryer u konstatua se, shoqëritë që zhvillojnë aktivitete artistike në salla të mbyllura realizojnë të ardhura nga shitja e biletave. Këto të ardhura, ndonëse përbëjnë një prej burimeve alternative financiare për mbulimin e shpenzimeve të aktivitetit, nuk evidentohen në një zë i veçantë në raportin përfundimtar që paraqitet në MTKRS, për mjetet financiare të përdorura për realizimin e aktivitetit, në kundërshtim me nenin 29, të ligjit nr.10352, datë 18/11/2010 “Për artin dhe Kulturën”.

Për këtë, **rekomandojmë që**, MTKRS dhe QKAK, për aktivitetet artistike dhe kulturore që zhvillohen në salla të mbyllura dhe që realizojnë të ardhura nga shitja e biletave të përcaktojnë në bilancin përfundimtar edhe këto të ardhura, me qëllim uljen e kostos së financimit nga MTKRS.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Artit
Drejtoria e Juridike
Menjëherë

7. Nga auditimi u konstatua se, shoqëritë sipërmarrëse që kanë lidhur kontrata me MTKRS, për realizimin e projekteve të ndryshme artistike dhe kulturore, furnizimet me bazë materiale apo shërbime të ndryshme që kryejnë me të tretë, likuidimin e shpenzimeve i kryejnë jashtë kanaleve të bankës.

Për këtë, **rekomandojmë që**, MTKRS dhe QKAK, të përcaktojnë rregulla dhe kushte të veçanta në kontratat e lidhura midis palëve, në mënyrë që pagesat e shpenzime dhe shërbimeve ndaj të tretëve, të kryhen vetëm nëpërmjet kanaleve bankare, me qëllim uljen e informalitetit dhe evazionit fiskal.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Artit
Drejtoria e Librit
Drejtoria e Rinisë
Drejtoria e Juridike
Menjëherë

8. Nga auditimi i kryer në programimin e fondeve buxhetore për njësitë vartëse u konstatua se, ndonëse disa institucione kanë një numër tepër të vogël të punonjësve, përsëri trajtohen si njësi vartëse. Për këto njësi, krahas fondit të pagave programohen edhe shpenzime operative dhe shpenzime të tjera, të cilat për t'u përdorur duhet t'i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik, ndërkohë që stafi tepër i vogël i tyre, nuk garanton respektimin e dispozitave ligjore, për faktin se, 9 federata sportive kanë nga 1 punonjës, 5 federata të tjera kanë nga 2 punonjës, e kështu me radhe 3 federata sportive kanë 4 punonjës, etj. Kjo mënyrë organizimi, sjell si pasojë rritjen artificiale të numrit të punonjësve e për rrjedhojë edhe të fondit të pagave dhe shpenzimeve operative, por edhe rritjen e kostos së auditimit.

Për këtë, **rekomandojmë që**, MTKRS të ngrejë një grup pune për të studiuar riorganizimin dhe rigrupimin e tyre, sipas natyrës dhe rajoneve, me qëllim jo vetëm kursimin e fondit të pagave por edhe uljen e kostos së auditimit, pasi në njësitë e vogla me një punonjës, kosto e auditimit shpesh here është më e lartë ose e barabartë me shpenzimet operative të vetë njësisë që auditohet.

Drejtoria e Buxhetit dhe Investimeve
Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Drejtoria e Auditimit të Brendshëm

Në vazhdimësi

9. Nga auditimi i kryer u konstatua se, në kundërshtim me nenin 15, të ligjit nr. 9154, datë 6/11/2003, “Për arkivat”, neni 29, “modeli” dhe nenet 6, 7 dhe 8 të “Normat teknike profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH”, dosjet e projekteve artistike dhe kulturore, janë të pa inventarizuara dhe të paarkivuara, mangësi e cila nuk bën të mundur auditimin e dokumentacionit sipas radhës kronologjike kohore të kryerjes së tyre.

Për këtë, **rekomandojmë që**, Drejtoritë respektive sipas projekteve dhe kontratave të lidhura të marrin masa të plota për sistemimin dhe inventarizimin e dosjeve të projekteve të përfunduara dhe arkivimin e tyre konform ligjit nr. 9154, date 6/11/2003, “Për arkivat”, neni 29, modeli 6, 7 dhe 8, të “Normave teknike profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH”.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Artit
Drejtoria e Librit
Drejtoria e Rinisë
Menjëherë

10. Nga auditimi u konstatua se, përveç të ardhurave nga buxheti i shtetit dhe sponsorizimeve, në zbatim të ligjit nr. 10033, datë 11/12/2008 “Për Lojërat e Fatit”, i ndryshuar dhe nenit 37, të ligjit nr. 9376, datë 21/4/2005 “Për Sportin”, me ndryshime, MTKRS-së i takojnë edhe të ardhura në masën 0,2% të totalit të të ardhurave që sigurohen nga lotaritë sportive. Për periudhën objekt auditimi MTKRS dhe Drejtoria e Përgjithshme e Sporteve, nuk kanë përfituar asnjë financim nga këto të ardhura.

Për këtë, **rekomandojmë që**, MTKRS, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Taksave, të hartojnë një marrëveshje të përbashkët në të cilën të përcaktohen detyra konkrete konform kreut VIII, neni 44 “Detyrimet tatimore”, paragrafi 5.2 të ligjit nr. 9376, datë 21/4/2005 “Për Sportin”, me ndryshime, në mënyrë që organizatorët e Lojërave të Fatit, nga të ardhurat e realizuara të derdhin 0,2% në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Sporteve pranë MTKRS, me qëllim, përdorimin e tyre për rritjen e cilësisë sportive.

Drejtoria e Buxhetit dhe Investimeve
Drejtoria e Përgjithshme e Sporteve
Menjëherë

11. Nga auditimi i kryer nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në TOBAP, është konstatuar se, Ministria e Financave ka autorizuar Drejtorinë e TOBAP respektivisht me shkresat nr, 1803/1, datë 24/2/2010, nr. 4843/1, datë 9/3/2011 dhe

nr. 407/1, datë 31/1/2012, në të cilat ka përcaktuar se: “*Shërbimi i pagesave dhe përfitimeve individuale të kontraktorëve të huaj të përkohshëm të cilët zhvillojnë aktivitete kulturore në Shqipëri në bashkëpunim me TOBAP të vazhdojë të kryhet jashtë sistemit bankar*”. Si rrjedhojë e këtij veprimi, në llogarinë e të ardhurave dytësore nuk dokumentohen për çdo vit vlera prej 1,050,000 lekë, për pasojë, kjo vlerë në mënyrë të padrejtë, përdoret jashtë kanaleve të bankës, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 30/4/2007 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 3 “Përkufizime’ pika 1.

Për këtë, **rekomandojmë që**, MTKRS të kërkojë nga Ministria e Financave, shfuqizimin e urdhrave të mësipërm, me qëllim disiplinimin e të ardhurave dhe dokumentimin e tyre në debi të llogarisë likuiduese të TOBAP dhe kredi të llogarisë 710.

Drejtoria e Buxhetit dhe Investimeve
Drejtoria juridike
Menjëherë

12. Për periudhën objekt auditimi, janë depozituar dhe protokolluar në MTKRS, 13 vendime të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pagimin e detyrueshëm në vlerën prej 19,612,661 lekë ose rikthim në punë të punonjësve, të cilët kanë fituar gjyqin me objekt “pushim padrejtësisht nga puna”. Gjatë vitit 2011 dhe 2012 për këta punonjës janë kryer pagesa nga artikulli 602, në vlerën prej 1,117,736 lekë, duke rritur artificialisht shpenzimet operative të institucionit.

Për këtë, **rekomandojmë që**, Drejtoria juridike e MTKRS, të marrë masa për apelimin e këtyre vendimeve pranë Gjykatës së Lartë Tiranë, duke paraqitur dhe argumentat përkatëse respektivisht për çdo punonjës të larguar nga detyra me objekt “thyerje e disiplinës së punës apo abuzim me detyrën”.

Gjithashtu MTKRS, të informojë dhe të bëjë prezent pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë, me qëllim mbrojtjen e intereseve të institucionit.

Drejtoria Juridike
Menjëherë

13. Nga auditimi i kryer në kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të krijuara gjatë viteve 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2011, u konstatua se, në partitarin analitik të llogarisë 423 “Personeli, paradhënie deficite dhe gjoba”, janë pasqyruar 61 persona debitorë për paradhënie të tërhequra por pa sistemuar apo likuiduar detyrimet në vlerën prej 61,929 Euro dhe 19,965 USD, konvertuar në shumën totale prej 10,866,756 lekë. Gjithashtu edhe ndaj punonjësve në marrëdhënie pune me MTKRS, që aktualisht janë debitorë për 39,501 Euro, nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin apo sistemim e detyrimeve.

Për këtë, **rekomandojmë**, marrjen e menjëhershme të masave nga Sektori i Financës, për sistemimin e detyrimeve në vlerën prej 39,501 Euro ndaj punonjësve të institucionit, që janë debitorë, si dhe marrjen e masave dhe fillimin e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve të punonjësve të larguar nga institucioni.

**Sektori i Financës
Drejtoria Juridike
Menjëherë**

14. Të merren masa të menjëhershme për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të projekteve artistike dhe kulturore të përfunduara konform nenit 15, të ligjit nr. 9154, datë 6/11/2003, “Për arkivat”, nenit 29 “modeli” dhe nenet 6, 7 dhe 8 të “Normave teknike profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH”.

**Drejtoria e Artit
Drejtoria e Librit
Drejtoria e Politikave Rinore
Sektori i Financës
Menjëherë**

15. Drejtoria e Artit, së bashku me Sektorin e Financës, të marrin masa për të verifikuar pranë QKR, dhe të saktësojnë llojin e veprimtarisë që kryejnë 17 subjekte të pasqyruara në aneksin nr. 2 bashkëlidhur. Në se janë të regjistruar në biznes të madh apo të vogël, dhe sipas rastit të informojnë Degën e Tatim Taksave për të ardhurat e realizuara, me qëllim uljen e evazionit fiskal nga shoqëritë sipërmarrëse.

**Sektori i Financës
Menjëherë**

16. Nga auditimi për “Rikonstruksionin e pjesshëm të ambienteve të M.T.K.R.S-së” i kryer në vitin 2011, për hidroizolim të tarracës së parasallës dhe pasojat e shkaktuara nga difektet në hidroizolim, që lidhen me punimet e kryera sipas procedurës së zhvilluar me urdhrin nr. 462, datë 13/7/2007, dhe për të nxjerrë një konkluzion më të saktë për punimet e kryera sipas urdhrit nr.462, datë 13/7/2007 në vlerën prej 60,000,000 lekë, grupi i audituesve të autorizuar të KLSH-së, pa të nevojshme krahasimin e punimeve të kryera në dy periudha të ndryshme për të njëjtin objekt. Për të bërë këtë krahasim, megjithëse u kërkua vënia në dispozicion e dokumentacionit teknik dhe financiar, por deri në përfundim të auditimit nuk u bë e mundur gjetja e këtyre dokumentave.

Për këtë, **rekomandojmë që**, Titullarët e MTKRS, të nxjerrin përgjegjësi konkrete ndaj personave përgjegjës, për këtë “zhdukje” të dosjes së “rikonstruksionit të institucionit”. Gjithashtu MTKRS, të marrë të gjitha masat për vënien menjëherë

në dispozicion të audituesve të autorizuar të KLSH-së, të të gjithë dokumentacionit që lidhet me rikonstrukcionin e objektit për procedurën e kryer me urdhrin nr. 462, datë 13/7/2007, pasi KLSH do t'i rikthehet edhe një herë brenda këtij viti për të kryer auditimin e këtij tenderi.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse
Menjëherë

B.2 Për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Nga auditimi i ushtruar në MTKRS, u konstatuan likuidime të fondeve publike, kundrejt Shoqërive Artistike, të cilat kanë paraqitur fatura të parregullta, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar”, si dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, duke paraqitur fatura tatimore të thjeshta, ndërkohë që në sistemin online, rezultojnë tatimpagues të t.v.sh.-së.

Për këtë, **rekomandojmë që**, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të verifikojë të gjithë subjektet sipas pasqyrës bashkëlidhur Raportit Përfundimtar, për periudhën 1/10/2010 deri në datën 31/3/2012.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në nenin 27, të ligjit nr. 7961, datë 12/7/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet e mëvonshme, të nxirren urdhrat për shpërbllim dëmi, të kryen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat, si më poshtë:

1. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës 180,000 lekë**, nga [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht për realizimin e projektit “Dodona Balet”.

Menjëherë

2. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 441,300 lekë**, nga [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht, për realizimin e projektit artistik “Tinguj dhe monumente”.

Menjëherë

3. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës 120,000 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht, për realizimin e projektit artistik “Dita ndërkombëtare e rinisë”.

Menjëherë

4. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 218,000 lekë**, nga [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht, për realizimin e projektit artistik “Për një pjesëmarrje të gruas në artet pamore”.

Menjëherë

5. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 120,000 lekë**, nga Fondacioni [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht për realizimin e projektit kulturor “Festivali i IV i riteve pagane”.

Menjëherë

6. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 864,977 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht për realizimin e projektit kulturor “Albanian Dance Meeting Festival”.

Menjëherë

7. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 326,600 lekë**, nga [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht, për realizimin e projektit kulturor me objekt “Koncert homazh kushtuar prof. Ymer Skënderi”.

Menjëherë

8. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 515,285 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht, për realizimin e projektit kulturor “Koncert i orkestrës frymore Tirana Show”.

Menjëherë

9. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 50,000 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht për realizimin e projektit kulturor “Festivali ndërkombëtar veror i muzikës”.

Menjëherë

10. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 380,000 lekë**, nga personi fizik [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht, për realizimin e projektit kulturor me objekt “Përmirësimi i imazhit në funksionimin e turizmit kulturor”.

Menjëherë

11. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 224,400 lekë**, nga personi privat [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht, për realizimin e projektit artistik “Baleti Hirushja”.

Menjëherë.

12. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 895,675 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht për realizimin e projektit artistik “Festivali European i Shqipërisë 2010”.

Menjëherë

13. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 35,000 lekë**, nga personi privat [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht për realizimin e projektit artistik “Korçës me dashuri”.

Menjëherë

14. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 50,000 lekë**, nga [REDACTED] për realizimin e projektit “Ditët e Trashëgimisë Kulturore”, si rrjedhojë e ndryshimit të destinacionit nga projekt kulturor, në copëzim të fondeve për blerje të vlerave materiale.

Menjëherë

15. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës 150,000 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht për realizimin e projektit artistik “Sofra e Ilire”.

Menjëherë

16. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 320,000 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht për realizimin e projektit artistik “Overground”.

Menjëherë

17. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 146,660 lekë**, nga personi privat [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht për realizimin e projektit artistik “Tinguj vere 2010”.

Menjëherë

18. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 730,900 lekë**, nga personi privat [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht për realizimin e projektit artistik “Takime muzikore të dy botëve”.

Menjëherë

19. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 50,000 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] për sa kryer pagesa të pajustificuara dhe në konflikt interesi për realizimin e Konkursit të VI kombëtar të Zërave Lirike, zhvilluar në muajin maj 2010”.

Menjëherë

20. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 461,700 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] për sa kryer pagesa në konflikt interesi, për realizimin e projektit artistik “Magic Nigts of Opera” të zhvilluar në Apolloni, në datën 2/9/2010.

Menjëherë

21. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 120,000 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht, për realizimin e projektit artistik “Festivali i IV-rt i Riteve Pagane”.

Menjëherë

22. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 200,000 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht, për realizimin e projektit artistik “Ballkanika-2010”.

Menjëherë

23. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 119,000 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht për realizimin e projektit artistik “Java Evropiane e të rinjve”.

Menjëherë

24. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 144,000 lekë**, nga [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht, për realizimin e aktivitetit artistik “Një Evrope pa kufij”.

Menjëherë

25. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 25,000 lekë**, nga [REDACTED] për sa përfituar më tepër në realizimin e projektit artistik “Festivali i IV-t i Riteve Pagane” në kundërshtim me ligjin nr.10352, datë 18/11/2010 për “Artin dhe Kulturën”, neni 8 dhe 9.

Menjëherë

26. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 25,000 lekë**, nga [REDACTED] për sa përfituar më tepër në realizimin e projektit artistik “Festivali i IV-t i Riteve Pagane” në kundërshtim me ligjin nr.10352, datë 18/11/2010 për “Artin dhe Kulturën”, neni 8 dhe 9.

Menjëherë

27. Të kërkohet në mënyrë ligjore **arkëtimi i vlerës prej 60,754 lekë**, nga shoqëria [REDACTED] për sa përfituar padrejtësisht në punimet e kryera me objekt “Rikonstruksion të pjesshëm të godinës së MKRST-së”.

Menjëherë.

28. Rekomandojmë që të bëhet vlerësimi përfundimtar i shpenzimeve të kryera nga [REDAKTUAR] në realizimin e projektit “Simfonia e Britmës” në vlerën prej 405,000 lekë dhe diferenca të arkëtohet si dëm ekonomik. Për këtë të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit brenda 20 ditëve nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

D. MASA DISIPLINORE

D.1 Mbështetur në ligjin nr. 8549, datë 11/11/1999 “Statusi i nëpunësit civil”, neni 25 pika 3 germa “ç” dhe pikën 1 e 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13/6/2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Kalim në një detyrë apo klasë më të ulët për një vit ”, për:

1. [REDAKTUAR] në cilësinë e Ish Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave për Artin, aktualisht i punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, të njoftohet Departamenti i Administratës Publike për dhënien e kësaj masa disiplinore; pasi në ushtrimin e detyrave funksionale u konstatuan veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore e konkretisht:

- Për periudhën objekt auditimi nuk ka marrë masa për të përcaktuar kritere të përgjithshme dhe të veçanta në vlerësimin e projekteve artistike dhe kulturore, dhe mbi bazën e këtyre të dhënave të përzgjidhen ato projekte që plotësojnë objektivat qëllimin dhe misionin e MTKRS, duke sjellë si pasojë që sistemet e vlerësimit, miratimit dhe të realizimit të të gjitha kategorive të projekteve të mos përzgjidhen nëpërmjet konkurrimit, por në kundërshtim me misionin e MTKRS-së, janë vlerësuar në mënyrë subjektive dhe jo nga njësi kompetente e përcaktuar me ligj.

- Në hartimin e dokumentacionit të vlerësimit të projekteve artistike dhe kulturore dhe deri në nënshkrimin e Memo-s për informimin e titullarit, është vepruar në kundërshtim me nenin 3, të ligjit nr. 9154, datë 6/11/2003 “Për Arkivat”, pasi jo vetëm procesverbalet e Komisionit të Kulturës, të pranuar nga Drejtoria e Artit, por gjithë dokumentacioni i përdorur për vlerësimin e projekteve artistike dhe kulturore; nuk janë trajtuar si dokumente të krijuara dhe të pranuar për t’u arkivuar, sipas përcaktimeve të nenit 18, pika 2 germa a, e ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për artin dhe kulturën”, të cilat jo vetëm kanë vlera artistike por mbartin dhe vlera ekonomike, pasi janë formularë dhe dokumente financiare bazë për likuidimin e shpenzimeve.

- Në kundërshtim me ligjin nr. 9631, datë 30/10/2006 “Për Artin Skenik”, dhe ligjin nr. 8480, datë 27/5/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale”, veprimtaria e Këshillit Artistik (bordit artistik) nuk është administruar konform nenit 2, të këtij ligji, pasi, në dosjet e projekteve artistike dhe kulturore nuk janë

administruar procesverbalet e mbledhjeve për mbështetjen financiare të shoqërive aplikuese, duke sjellë si pasojë vështirësi në rakordimin e vlerave të miratuara nga Këshilli i Kulturës dhe kontratave të lidhura nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Artit, si dhe ka nënshkruar memon për informimin e titullarit për projektin “Dodona Balet”, me vlerë 200,000 lekë më tepër se sa vendimi i “Këshillit të Kulturës”.

- Në kundërshtim me pikën 2, të VKM nr. 1173, datë 6/11/2009, nuk janë marrë masa për çeljen e regjistrimit të subjekteve apo shoqatave që kanë eksperiencë në realizimin e projekteve artistike dhe kulturore, i cili do të shërbejë për vlerësimin e shoqërive që plotësojnë kushtet për të përfituar mbështetje financiare për realizimin e misionit të MTKRS dhe seleksionimin e shoqërive dhe individëve të veçantë që nuk mund të jenë sipërmarrës të aktiviteteve artistike dhe kulturore.

- Në kundërshtim me Udhëzimin e MTKRS nr. 258, datë 12/1/2010 “Mbi dokumentacionin që duhet të plotësojnë personat fizikë e juridikë vendas, që aplikojnë për mbështetje financiare nga MTKRS dhe procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të projekteve, kreu III, pika 11, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Artit nuk ka parashikuar në preventivat e miratuara edhe shpenzimet për monitorimin e aktiviteteve artistike dhe kulturore, ndonëse kjo detyrë është funksionale dhe është përcaktuar në përkrahjet individuale të punës të çdo punonjësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Artit.

- Në kundërshtim me nenin 2 dhe 5, germa “a”, neni 12, pikat 1 dhe 5 dhe neni 15, pika 4 dhe 9, të ligjit 10018, datë 13/11/2008, “Për Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit”, ka lejuar të lidhen kontratat për projektet artistike dhe kulturore me shoqëritë sipërmarrëse pa marrë më parë mendimin e “Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit”.

- Në kundërshtim me nenin 50, të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ka lejuar miratimin e projekteve artistike dhe kulturore dhe lidhjen e kontratave në vlera më tepër se fondet e çelura nga buxheti i shtetit (pa projektet e rinisë dhe të librit) përkatësisht 69,754 mijë lekë, ose 83% më tepër, duke sjellë si pasojë vështirësi financiare për vitet pasardhëse.

2. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtore e Artit, pasi në ushtrimin e detyrave funksionale u konstatuan veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore e konkretisht:

- Për periudhën objekt auditimi nuk ka marrë masa për të përcaktuar kritere të përgjithshme dhe të veçanta në vlerësimin e projekteve artistike dhe kulturore, dhe mbi bazën e këtyre të dhënave të përzgjidhen ato projekte që plotësojnë objektivat qëllimin dhe misionin e MTKRS, duke sjellë si pasojë që sistemet e vlerësimit, miratimit dhe të realizimit të të gjitha kategorive të projekteve të mos përzgjidhen nëpërmjet konkurrimit, por në kundërshtim me misionin e MTKRS-së, janë vlerësuar në mënyrë subjektive dhe jo nga njësia kompetente e përcaktuar me ligj.

- Në hartimin e dokumentacionit të vlerësimit të projekteve artistike dhe kulturore dhe deri në nënshkrimin e Memo-s për informimin e titullarit, është vepruar në kundërshtim me nenin 3, të ligjit nr. 9154, datë 6/11/2003 “Për Arkivat”, pasi jo vetëm procesverbalet e Komisionit të Kulturës, të pranuar nga Drejtoria e Artit, por gjithë dokumentacioni i përdorur për vlerësimin e projekteve artistike dhe kulturore; nuk janë trajtuar si dokumente të krijuara dhe të pranuar për t’u arkivuar, sipas përcaktimeve të nenit 18, pika 2 germa a, e ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për artin dhe kulturën”, të cilat jo vetëm kanë vlera artistike por mbartin dhe vlera ekonomike, pasi janë formularë dhe dokumente financiare bazë për likuidimin e shpenzimeve.

- Në kundërshtim me ligjin nr. 9631, datë 30/10/2006 “Për Artin Skenik”, dhe ligjin nr. 8480, datë 27/5/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale”, veprimtaria e Këshillit Artistik (bordit artistik) nuk është administruar konform nenit 2, të këtij ligji, pasi, në dosjet e projekteve artistike dhe kulturore nuk janë administruar procesverbalet e mbledhjeve për mbështetjen financiare të shoqërive aplikuese, duke sjellë si pasojë vështirësi në rakordimin e vlerave të miratuara nga Këshilli i Kulturës dhe kontratave të lidhura nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Artit.

- Ka nënshkruar kontratën për projektin “Dodona Balet”, me vlerë 200,000 lekë më tepër se sa vendimi i “Këshillit të Kulturës”.

- Në kundërshtim me pikën 2, të VKM nr. 1173, datë 6/11/2009, nuk janë marrë masa për çeljen e regjistrimit të subjekteve apo shoqatave që kanë eksperiencë në realizimin e projekteve artistike dhe kulturore, i cili do të shërbejë për vlerësimin e shoqërive që plotësojnë kushtet për të përfituar mbështetje financiare për realizimin e misionit të MTKRS dhe seleksionimin e shoqërive dhe individëve të veçantë që nuk mund të jenë sipërmarrës të aktiviteteve artistike dhe kulturore.

- Në kundërshtim me Udhëzimin e MTKRS nr. 258, datë 12/1/2010 “Mbi dokumentacionin që duhet të plotësojnë personat fizikë e juridikë vendas, që aplikojnë për mbështetje financiare nga MTKRS dhe procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të projekteve, kreu III, pika 11, Drejtoria e Artit nuk ka parashikuar në preventivat e miratuara edhe shpenzimet për monitorimin e aktiviteteve artistike dhe kulturore, ndonëse kjo detyrë është funksionale dhe është përcaktuar në përshkrimet individuale të punës të çdo punonjësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Artit.

- Në kundërshtim me nenin 2 dhe 5, germa “a”, neni 12, pikat 1 dhe 5 dhe neni 15, pika 4 dhe 9, të ligjit 10018, date 13/11/2008, “Për Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit”, ka lejuar të lidhen kontratat për projektet artistike dhe kulturore me shoqëritë sipërmarrëse pa marrë më parë mendimin e “Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit”.

- Në kundërshtim me nenin 50, të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ka lejuar miratimin e projekteve

artistike dhe kulturore dhe lidhjen e kontratave në vlera më tepër se fondet e çelura nga buxheti i shtetit (pa projektet e rinisë dhe të librit) përkatësisht 69,754 mijë lekë, ose 83% më tepër, duke sjellë si pasojë vështirësi financiare për vitet pasardhëse.

3. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës, pasi gjatë ushtrimit të detyrës funksionale:

- Ka vepruar në kundërshtim me nenin 4, pika 18 e ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar”, pasi nuk ka marrë masa të plota për ushtrimin e kontroleve pas faktit të çdo transaksioni financiar, sipas një plani, për të verifikuar nëse fondet publike në projektet artistike dhe kulturore shpenzohen me efektivitet.

- Dokumentacioni i pranuar dhe për likuidimin e shpenzimeve të disa projekteve artistike dhe kulturore nuk është konform dispozitave ligjore, për të justifikuar qëllimin e përcaktuar, në përputhje me detyrimet e marra përsipër, dhe për arritjen e rezultateve të pritshme nëpërmjet përdorimit efektiv të fondeve publike. Ka lejuar likuidimin e shpenzimeve të projekteve artistike dhe kulturore pa depozituar materialet justifikuese si, fotografi, CD, apo edhe materiale të tjera të përcaktuara në nenin 2 të kontratave të lidhura midis palëve, duke sjellë si pasojë përfitime të padrejta nga disa shoqëri në vlerën prej 6,913,497 lekë, trajtuar me hollësisht në kapitullin “Mbi projektet artistike dhe kulturore”.

- Ka kryer pagesë në favor të shoqërisë “Syri Blu” për realizimin e projektit kulturor “Festivali European i Shqipërisë 2010”, me një preventiv të pa nënshkruar dhe të pamiratur nga asnjë punonjës i Drejtorisë së Artit dhe i ndryshëm nga preventivi origjinal, duke sjellë si pasojë dëm ekonomik për fondet buxhetore në vlerën prej 895,675 lekë.

- Ka vepruar në kundërshtim me nenin 12, pika 3 germat “g” dhe “gj” të ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010, pasi nuk ka marrë masa për arkëtimin dhe sistemimin e debitorëve, nuk ka informuar titullarin e institucionit, për 35 punonjësit e MTKRS, të cilët sipas partitarit të llogarisë 423, aktualisht janë debitorë për shumën 39,501 euro konvertuar në vlerën prej 5,371,296 lekë, të cilët prej vitit 2007 e në vazhdim, nuk kanë shlyer detyrimet që rrjedhin nga paradhëniet e ndryshme të pa likuiduara në afatet e përcaktuara, si dhe ka kryer pagesa për paradhënie të dytë pa likuiduar paradhënien e parë.

- Nuk ka marrë masa për zbatimin e urdhrin të ministrit nr. 471, datë 2/9/2010 për realizimin e projektit “Bialja e Arkitekturës” me financim nga fondi i UNESCO-s.

D.2 Mbështetur në ligjin nr. 8549, datë 11/11/1999 “Statusi i nëpunësit civil” neni 25, pika 3, germa a, dhe pikën 1 e 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.

306, datë 13/6/2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me shkrim”, për:

1. ██████████ me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Artit, pasi në ushtrimin e detyrave funksionale u konstatuan veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore e konkretisht:

- Në hartimin e dokumentacionit të vlerësimit të projekteve artistike dhe kulturore dhe deri në informimin e titullarit me Memo, u konstatua se në asnjë prej këtyre dokumentave nuk ka marrë masa për të disiplinimin e dokumentacionit të miratimit të projekteve artistike dhe kulturore, pasi në to mungon data dhe numri i protokollit, duke sjellë si pasojë që periudha prej momentit të miratimit të çdo projekti nga Këshilli i Kulturës, vlerësimit të Drejtorisë së Artit dhe deri në marrjen e miratimit nga titullari për lidhjen e kontratës, të mos jetë e kufizuar me afatin kohor maksimal dy ditë, në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 1173, datë 6/11/2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”, mangësi e cila lë shteg për zgjatjen pa kufi të periudhës së lidhjes së kontratës.

- Në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 1173, datë 6/11/2009, nuk ka marrë masa për çeljen e regjistrimit të subjekteve apo shoqatave që kanë eksperiencë në realizimin e projekteve artistike dhe kulturore, i cili do të shërbejë për vlerësimin e shoqërive që plotësojnë kushtet për të përfituar mbështetje financiare për realizimin e misionit të MTKRS dhe seleksionimin e shoqërive dhe individëve të veçantë që nuk mund të jenë sipërmarrës të aktiviteteve artistike dhe kulturore.

- Në kundërshtim me Udhëzimin e MTKRS nr. 258, datë 12/1/2010 “Mbi dokumentacionin që duhet të plotësojnë personat fizikë e juridikë vendas, që aplikojnë për mbështetje financiare nga MTKRS dhe procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të projekteve”, pika 11, nuk janë parashikuar shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit për jo më pak se 2 persona në një zë të veçantë në të gjitha preventivat e hartuara dhe të miratuara për mbështetjen financiare. Kjo mangësi ka bërë që aktivitetet artistike dhe kulturore të mos monitorohen nga përfaqësuesit e MTKRS, duke sjellë si pasojë që, shumë projekte artistike dhe kulturore të mos realizohen sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, e për rrjedhojë disa shoqëri sipërmarrëse kanë përfituar në mënyrë të pa drejtë fonde buxhetore.

- Në kundërshtim me nenin 2 dhe 5, germa “a”, neni 12, pikat 1 dhe 5 dhe neni 15, pika 4 dhe 9, të ligjit 10018, date 13/11/2008, “Për Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit”, kontratat për projektet artistike dhe kulturore me shoqëritë sipërmarrëse janë lidhur pa marrë më parë mendimin e “Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit”.

- Në kundërshtim me nenin 3, të ligjit nr. 9154, datë 6/11/2003 “Për Arkivat”, procesverbalet e Komisionit të Kulturës dhe gjithë dokumentacioni tjetër që është përdorur për vlerësimin e projekteve artistike dhe kulturore; nuk janë trajtuar si dokumente të krijuara dhe të pranuar për t’u arkivuar, sipas përcaktimeve të nenit 18, pika 2 germa a, e ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për artin dhe kulturën”, të cilat jo vetëm kanë vlera artistike por mbartin dhe vlera ekonomike, pasi janë formularë dhe dokumente financiare bazë për likuidimin e shpenzimeve.

- Në kundërshtim me ligjin nr. 9631, datë 30/10/2006 “Për Artin Skenik”, dhe ligjin nr. 8480, datë 27/5/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale”, veprimtaria e Këshillit Artistik (bordit artistik) nuk është dokumentuar konform nenit 2, të këtij ligji, pasi në dosjet e projekteve nuk janë administruar procesverbalet e mbledhjeve, duke sjellë si pasojë vështirësi në rakordimin e vlerave të miratuara nga Këshilli i Kulturës dhe vlerave të miratuara nga titullari, pasi në dy raste u konstatuan kontrata të lidhura më tepër në vlerën 260,000 lekë, se sa miratimi nga “Këshilli i Kulturës”.

- Në kundërshtim me nenit 50, të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, janë miratuar projekte artistike dhe kulturore dhe lidhur kontrata më tepër për vlerën 69,754 mijë lekë ose 83 % më tepër se fondet e çelura nga buxheti i shtetit (pa projektet e rinisë dhe librit), duke sjellë si pasojë vështirësi financiare për vitet pasardhëse.

2. [REDAKTUAR] në cilësinë e Punonjësit të Autorizuar, për realizimin e projektit kulturor “Ditët e Trashëgimisë Kulturore”, duke ndryshuar destinacionin nga “projekt kulturor”, në copëzim të fondeve nëpërmjet lidhjes së kontratës për “blerje materiale” me pasojë dëmin ekonomik në vlerën prej **50,000 lekë**.

- Në kundërshtim me nenin 2 dhe 5, germa “a”, neni 12, pikat 1 dhe 5 dhe neni 15, pika 4 dhe 9, të ligjit 10018, date 13/11/2008, “Për Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit”, kontrata është lidhur pa marrë më parë mendimin e “Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit”.

3. Për [REDAKTUAR] në cilësinë e Specialistes së Politikave Rinore, e cila ka nënshkruar kontrata për realizimin e disa projekteve të Drejtorisë së Politikave Rinore, pa përcaktuar 2 punonjës për monitorimin e aktivitetit, si dhe nuk ka kërkuar depozitimin në dosjet e projekteve të materialeve justifikuese si fotografi, CD apo edhe dokumenta të tjera që provojnë kryerjen e aktiviteteve, konform nenit 2 të kontratës tip.

- Në kundërshtim me nenin 2 dhe 5, germa “a”, neni 12, pikat 1 dhe 5 dhe neni 15, pika 4 dhe 9, të ligjit 10018, date 13/11/2008, “Për Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit”, kontratat për projektet me shoqëritë sipërmarrëse janë lidhur pa marrë më parë mendimin e “Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit”.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Qeram Cibaku Përgjegjës Grupi, Rajmond Koçi, Pranvera Doçi, Faik Qosja dhe Kujtim Rama. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Juristi i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Koço Sokoli (në mungesë të Drejtirit të Departamentit dhe me porosi, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT